**VENDIM**
**Nr. 388, datë 12.6.2019**

# PËR MIRATIMIN E NDRYSHIMIT TË STATUSIT, NGA KATEGORIA E RESURSIT "TOKË BUJQËSORE" NË "TOKË URBANE", TRUALL, TË PASURISË ME NUMËR 274/18, ZONA KADASTRALE 3115, BASHKIA PËRMET

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 11/1, të ligjit nr. 8752, datë 26.3.2001, "Për krijimin dhe funksionimin e strukturave për administrimin dhe mbrojtjen e tokës", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Turizmit dhe Mjedisit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e ndryshimit të statusit, nga kategoria e resursit "tokë bujqësore" në "tokë urbane", truall, të pasurisë me numër 274/18, zona kadastrale 3115, Bashkia Përmet, sipas certifikatës së pasurisë, hartës treguese dhe lidhjes nr. 1, bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Drejtoria e Administrimit dhe e Mbrojtjes së Tokës, Qarku Gjirokastër, të pasqyrojë në dokumentacionin kadastral (LN) ndryshimin e resursit nga "tokë bujqësore" në "tokë urbane", truall, të pasurisë me numër 274/18, zona kadastrale 3115, Bashkia Përmet.
3. Agjencia Shtetërore e Kadastrës të bëjë ndryshimin e llojit të pasurisë në certifikatën e pasurisë, sipas të dhënave për pasurinë e përcaktuar në pikën 1, të këtij vendimi.
4. Ngarkohen Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Bashkia Përmet dhe Këshilli i Qarkut Gjirokastër për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
**Erion Braçe**

Lidhja nr. 1

| **Nr. Rend** | **Qarku** | **Bashkia** | **Zona kadastrale** | **Adresa e pasurisë** | **Numri i pasurisë** | **Sipërfaqja në $m^2$** | **Sipërfaqja që përdoret për zhvillim $m^2$** | **Sipërfaqja ndërtimore $m^2$** | **Emërtimi i Strukturës** |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | Gjirokastër | Përmet | 3115 | Qilarisht | 274/18 | 2575$m^2$ | 2575 $m^2$ | 780.90 | Kantina Zavalani Farm |

# REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**ZYRA E REGJISTRIMIT TE PASURISË SË PALUAJTSHME**

## ÇERTIFIKATË

**PËR VËRTETIM PRONËSIE**

1076407

Zyra e Regjistrimit Z.V.R.P.P. PËRMET — Zona Kadastrale Nr. 3115

Numri i Pasurisë 274/18 — Volumi 6 — Faqe 172

Adresa e Pasurisë QILARISHT

Lloji i Pasurisë ARE

Sipërfaqja Totale 2575.00 m2

Nga kjo : Sa Truall ______ — Nga kjo : Sa Ndërtesa -

Nqs pallat : Kuota e pjesëmarrjes - ______ %

**KJO ÇERTIFIKATË LËSHOHET PËR TË VËRTETUAR QË**

Zoti ( Zotërinjtë )

| Emri | Atësia | Mbiemri | Pjesa | Adresa |
|---|---|---|---|---|
| ARBEN | SABRI | HASANI | 1/1 | TIRANË |

- është pronar i pasurisë me numër 274/18
- janë bashkëpronarë sipas pjeseve më lart ______
- është përfaqësues i familjes e cila ka në pronësi ______
- kufizimet e pasurisë janë : V ______, L ______, J ______, P ______

**Kjo çertifikatë plotësohet në përputhje me Ligjin e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme.**

**Kjo çertifikatë lëshohet sipas kërkesës së paraqitur nga i (të) interesuari (t) më da[illegible]/6/2018 Nr.601**

Data e lëshimit të çertifikatës

6/8/2018

Lëshuesi i çertifikatës

REGJISTRUESI

( VASIL PANO )

# HARTE TREGUESE E REGJISTRIMIT

Fragment

| ZYRA VENDORE E REGJISTRIMIT TE PASURIVE TE PALUAJTSHME PERMET | A. IDENTIFIKIMI I PASURISE |
| --- | --- |
| **REGJISTRUESI** | ZONA KADASTRALE 3115 Nr. i pasurise 274/18 V. 6 Fq. 172 |
| | INDEKSI I HARTES K-34-137-(77-C) SHKALLA 1:2500 |
| | ADRESA E PASURISE Rrethi Permet Q./F QILARISHT |
| | RR/L ______ P/G. ______ Shk ______ K ______ Ap/Nj. ______ |
| Vasil PANO | B. KUFIZIMET / C. PRONARI/ET |
| | V. 274/12 |
| | L. 274/6 |
| | J. 274/13, 274/14 — ARBEN SABRI HASANI |
| | P. 274/12 |
| | DATA 28/06/2018 Ora ______ Nr. Kerkeses 601 |

